



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KURBIN**

**KERKESE**

**(Per caktimin e mases se sigurimit pasuror)**

E Prokurorise se rrethit gjyqesor Kurbin, e perfaqesuar nga Prokurore **AJOLA PRENCI**

**OBJEKTI:** Kerkohet caktimi i mases se sigurimit pasuror te “sekuestros preventive”

**BAZA LIGJORE:** Neni 274/2 te KPrP.

Se më datën 01.10.2016 Prokuroria e rrethit gjyqesor Kurbin ka rregjistruar procedimin penal me numer 406, mbi bazen e akteve te ardhura nga ana e Sektorit për Hetimin e Krimet Ekonomik e Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, me objekt veprën penale të «Pastrimit të produkteve të veprës penale apo të veprimtarisë kriminale» të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

**Nga aktet qe ndodhen ne dosjen hetimore rezulton :**

Drejtoria e Përgjithshme Për Hetimin e Krimet të Organizuar dhe Krimet e Rënda, është informuar nga Zyra Kombëtare Europol se autoritetet e drejtësisë spanjolle po kryejnë një hetim në lidhje me një grup të lëvizshëm kriminal, i përbërë nga disa shtetas shqiptarë të përfshirë në vjedhje dhe në pastrim parash dhe konkretisht:

Më datë 14.03.2016, tre shtetas janë arrestuar si autorë të disa vjedhjeve në Galicia, Spanjë dhe konkretisht:

- **Emiljan Zef GJEZAJ**, i datëlindjes 22.04.1985, lindur në Shllinza, Krujë dhe banues në Fushë-Kuqe, Kurbin.
- **Gjon (Shkëlzen) Pjetër GJEZAJ**, i datëlindjes 22.05.1983, lindur në Shllinza, Krujë dhe banues në Laç, Kurbin.
- **Anastas (Enkeled) Faj OSMANI**, i datëlindjes 13.09.1982, lindur në Mamurras, Krujë dhe banues në Laç, Kurbin.

Gjatë kontrollit të banesave të tyre u gjetën dhe u sekuestruan rreth 2 kg ar dhe 12 000 euro, para cash.

Në kuadër të hetimeve u zbulua se anëtarët e këtij grupi kanë marrë përfitime nga Shqipëria si dhe në Greqi.

Një nga personat e arrestuar është posedues i disa kartave të kreditit të bankave greke si dhe kishte marrë shumë fatura të Bankës “PIRAEUS”.

Njeri nga të arrestuarit dhe konkretisht, shtetasi Gjon Gjezaj u arrestua gjatë një vjedhje të ndodhur në Francë dhe gjatë këtij veprimi të policisë, dy persona të tjerë arritën të largoheshin. Autoritetet spanjolle po hetojnë shtetasit Emiljan Gjezaj dhe Anastas Osmani, të cilët mendohet të jenë dy personat e larguar.

Për shtetasit e mësipërm, ka dyshime të bazuara në lidhje shumat e mëdha të investuara në pasuri të paluajtshme si dhe origjinën e këtyre shumave.

**Ne vijim te hetimeve ne lidhje me shtetasin Gjon Gjezaj dhe familjaret e tij jane identifikuar keto pasuri te paluajtshme:**

Kontrata noteriale të lidhura, për blerje pasurish nga shtetasi Gjon Gjezaj:

- Sipas kontratës me Nr. 297 Rep./Nr. 99 Kol. datë 28.01.2015, shtetasi Gjon Gjezaj ka lidhur një kontratë për kalim të drejtash reale për një apartament banimi me shoqërinë "TRUST" sh.p.k me NIPT L31404013K. Ky apartament ndodhet ne Kashar, apartament i ndertuar nga nga shoqerua "Sandy" mbi bazen e vendimit me numer 14, te dates 21.05.2010 te Komunes Kashar. Apartamenti eshte blere për shumën 41 800 euro. **Bazuar ne kete kontrate me lidhjen e saj behet pagesa e kestit te pare ne shumen 21.800 euro. Pjesa e mbetur do te paguhet me keste mujore 4000 euro cdo muaj pagese e cila duhet te kryhet deri me daten 20.06.2015. (Ne lidhje me kete pasuri te paluajtshme jane pyetur familjare te shtetasit Gjon gjezaj te cilet kane deklaruar se likujdimi i detyrimit eshte bere ne total).**
- Sipas kontratës Nr. 3853 Rep./Nr. 929 Kol. datë 05.06.2012, shtetasi Gjon Zef Gjezaj (në kontratë ka datëlindjen 09.06.1983) ka prenotuar blerjen e një pasurie të paluajtshme tek shoqëria "2AL" Shpk me NIPT K31317006T, për shumën 38 500 euro. Burimi i të ardhurave deklarohet: të ardhura të veta. **Shuma është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale me nënshkrimin e kësaj kontrate.**
- Sipas kontratës Nr. 4375 Rep./Nr. 1355 Kol. datë 22.07.2013, shtetasi Gjon Gjezaj ka porositur ndertimin e nje apartamenti banimi, nje dyqani dhe vend parkimi, te lidhur me shoqerine ndertuse "2 A-L sh.p.k." objekte te cilat do te ndertoheshin ne Yzberisht Tirane. Siperfaqja e apartamentit te porositur 121,2 m2, dyqani me siperfaqe 96 m2 dhe vendparkimi me siperfaqe 58.69 m2 (ndertimi do te kryejej mbi bazen e lejes se ndertimit dhe lejes se zhvillimit me numer 153, te dates 21.12.2012 te Komunes Kashar). **Cmimi per dyqanin e porositur dhe parkimin 32.240 euro e cila eshte likujduar totalisht jashte zyres noteriale. Cmimi per dyqanin e porositur paguhet ne kete menyre: ne momentin e nenshkrimit te kontrates pala porositese paguar 20.000 euro dhe 29.000 euro do te paguhen ne momentin e marrjes ne dorezim te ambjentit te porositur.**
- Sipas kontratës Nr. 4373 Rep./Nr. 1353 Kol. datë 22.07.2013, shtetasja Manjola Arapaj (motra e shtetasit Gjon Gjezaj) ka porositur ndertimin e nje apartamenti banimi me siperfaqen 74,9 m2, te cilat do te ndertoheshin ne Yzberisht Tirane nga shoqeria e ndertimit "2 A-L sh.p.k.". (ndertimi do te kryejej mbi bazen e lejes se ndertimit dhe lejes se zhvillimit me numer 153, te dates 21.12.2012 te Komunes Kashar). **Cmimi per objektin e porositur 14 980 euro te cilat jane likujduar totalisht jashte zyres noteriale.**
- Pasuria me nr. 77/1, vol. 3 fq. 98, Zona Kadastrale 3332, lloji i pasurisë "Arë", me sipërfaqe totale 27 000 m2; përfituar me Ligjin Nr. 7501 datë 19.07.1991 "Për tokën", me

AMTP me Nr. 44, datë 30.04.1993, ndodhur në fshatin Adriatik, pasuri e cila rezulton te jete ne emer te shtetasit Gjon Gjezaj.

**-Në lidhje me transaksionet financiare, rezulton se:**

Nga verifikimet e bëra, rezulton se ka informacione për transaksione financiare vetëm në emër të shtetasit Gjon Gjezaj, si vijon:

- Më datë 16.04.2013 shtetasja Manjola Arapaj derdh shumën prej 3 000 000 lekë në depozitën e përbashkët të shtetasve Gjon Pjetër Gjezaj dhe Manjola Dervish Arapaj në Bankën “Kombëtare Tregtare”. Burimi i të ardhurave deklarohet nga emigracioni.
- Më datë 22.07.2013 shtetasi Gjon Gjezaj tërheq me kërkesë nga llogaria e përbashkët në Bankën “Kombëtare Tregtare” shumën prej 2 800 000 lekë. Burimi i të ardhurave deklarohet nga: të ardhura nga likuidim depozite (nga emigracioni).
- Më datë 28.01.2015 shtetasi Gjon Gjezaj derdh në Bankën “Kombëtare Tregtare” shumën prej 18 800 euro, me përshkrimin: kalim për blerje apartamenti, likuidim i pjesëshëm. Burimi i të ardhurave deklarohet: kursime familjare.

Më datën 29.06.2016, nga ana jonë është kërkuar informacion nga Bankat e nivelit të dytë, në lidhje me transaksionet e kryera në llogaritë bankare të shtetasve Emiljan Zef Gjezaj, Gjon Pjetër Gjezaj, Enkelejd Faj Osmani dhe familjarëve të tyre.

Bazuar në përgjigjet e ardhura nga Bankat e nivelit të dytë, shtetasit e sipërpërmendur dhe familjarët e tyre aktualisht nuk kanë gjendje parash në llogaritë e tyre bankare të çelura në këto banka ose transaksionet e kryera dhe shumat në llogari janë të pa përfillshme dhe pa rëndësi për hetimin. **Nderkohe nga informacionet e marra nga banka te nivelit te dyte rezultojne levizjet bankare te lartpermendura.**

**Ne lidhje me automjetet ne pronesi rezulton se:**

- 1- Shtetasi Gjon (Shkëlzen) Pjetër Gjezaj, ka patur ne pronesi automjetin me targe AA757FU dhe me daten 23.11.2015 ka ndryshuar pronesine duke ia shitur shtetasit Alban Xhavit Mema, i cili e ka regjistruar me targen AA505MX.
- 2- Shtetasja Manjola Arapaj (motra e Gjon Pjetër Gjezaj), ka patur ne pronesi automjetin me targe LA9958A dhe me daten 30.07.2013, ka ndryshuar pronesine.

**Ne lidhje me bizneset nuk rezulton qe familja Gjezaj te kete te rregjistruara biznese ne Q.K.R.**

**Burimet e te ardhurave:**

**Nga deklarimet e marr nga shtetasit Manjola Arapaj dhe Pjeter Gjezaj pretendohen:**

1-Te ardhura nga emigracioni, qe eshte puna e shtetasit Gjon Gjezaj dhe Pjeter Gjezaj jashte shtetit, pa percaktuar nje shume konkrete te te ardhurave. (Ne lidhje me kete pretendim eshte kerkuar informacion dhe nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave jemi informuar me shkresen me numer 14842/1 prot, te dates 30.06.2017 se shtetasi Gjon Gjezaj dhe familjaret e tij nuk kane deklaruar para cash, cek apo metale e sende te cmuara ne pikat e kalimit kufitar ne periudhen maj 2004-31 maj 2017) .

2-Te ardhura nga pensioni i shtetases Lumturie Gjezaj per vitet 204-2017.

3-Te ardhura nga paga si sekretare gjyqesore e shtetases Manjola Arapaj si sekretare gjyqesore per periudhen 2004-2016.

4-Te ardhura nga punoa si infermiere e nenes,

#### **Shpjegime per pasurite dhe levizjet bankare:**

I është marrë deklarim si person që ka dijeni për rrethanat e veprës penale shtetases Manjola Arapaj, e cila e pyetur në lidhje me pasuritë e paluajtshme në pronësinë e saj e të familjarëve dhe burimet e të ardhurave për blerjen e këtyre pasurive, ka deklaruar:

Aktualisht në pronësi të familjes kemi një Apartament garsonierë me sipërfaqe rreth 40 m2, në të cilën banojmë. Shtetasi Gjon (Shkëlzen) Pjetër GJEZAJ është vëllai im, ndërsa Emiljan Zef GJEZAJ është djali i xhaxhait tim. Aktualisht të dy ndodhen të arrestuar në Spanjë që prej muajit Mars 2016.

Në lidhje me tre apartamente të cilësuar në tre kontrata porosie, me kontratë noteriale Nr. 297 Rep./Nr. 99 Kol. datë 28.01.2015; me kontratë noteriale Nr. 3853 Rep./Nr. 929 Kol. datë 05.06.2012; me kontratë noteriale Nr. 4375 Rep./Nr. 1355 Kol. datë 22.07.2013, dua të deklaroj se kontratat janë lidhur nga vëllai im Gjon Gjezaj, por vetëm një apartament banimi është në pronësinë e vëllait tim Gjon Gjezaj, konkretisht apartamenti i blerë nga shtetasi Gjon Gjezaj, me shumën 41 800 Euro, nga shoqëria "TRUST" sh.p.k, me NIPT L31404013K, me kontratë noteriale me Nr. 297 Rep./Nr. 99 Kol. datë 28.01.2015. Të ardhurat për blerjen e këtij apartamenti: Shoqërisë i është dhënë një automjet Benz C220 CDI me targa AA 757 FU, në pronësi të vëllait, më pas pjesa e mbetur e detyrimit është bërë me këste. Të ardhurat e tjera për blerjen e këtij apartamenti janë të mbledhura nga puna e babait dhe vëllait ne emigracion në Greqi vitet 1996 -2005 (me periudha), pasi babim im së bashku me vëllain tim Gjon Gjezaj, kanë punuar të dy së bashku në Greqi, nëpër kantiere, si saldator dhe kanë siguruar shuma të konsiderueshme të cilat janë përdorur për blerjen e këtij apartamenti si dhe për përballimin e shpenzimeve të familjes. Gjithashtu në kursimet e familjes janë edhe të ardhurat e mia nga paga, si dhe të mamasë sime e cila ka punuar si infermiere dhe prej vitit mars 2013 ka dalë në pension.

Ndërsa dy apartamentet e tjera të banimit, të porositura te shoqëria "2AL" sh.p.k, me NIPT K31317006T, me kontratë noteriale Nr. 3853 Rep./Nr. 929 Kol. datë 05.06.2012 të ndodhura Kashar, dhe kontrata noteriale Nr. 4375 Rep./Nr. 1355 Kol. datë 22.07.2013, të porositura në vitin 2013, nuk kanë kaluar në pronësinë e vëllait tim Gjon Gjezaj, pasi shoqëria ka falimentuar dhe nuk ka qenë korrekte në ndërtimin e tyre, si rrjedhojë nga ana jonë nuk kemi kryer asnjë pagesë, që nga momenti i lidhjes së kontratës së porosisë, pallati ka ngelur thjesht ne themel dhe nuk ka vazhduar ndërtimi. **(ne kontrata noteriale shenohet se ne lidhje me apartamentet e porositura ka pasur pagesa jashte zyres noteriale te kryera sipas vlerave te percaktuar ne kontrate).**

-Në lidhje me transaksionin e datës 16.04.2013, në Bankën "Kombëtare Tregtare, ku shtetasja Manjola Arapaj ka derdhur shumën prej 3 000 000 lekë në depozitën e përbashkët të shtetasve Gjon Pjetër Gjezaj dhe Manjola Dervish Arapaj në Bankën "Kombëtare Tregtare", shtetasja Manjola Arapaj ka deklaruar se burimi i këtyre të ardhurave ishte nga puna ne emigracion e babait tim Pjetër Gjezaj dhe vëllait tim Gjon Pjetër Gjezaj, une vetem kam kryer veprime ne llogarine e përbashkët në Bankën "Kombëtare Tregtare".

Shtetasja Manjola Arapaj, ka deklaruar se ajo dhe familjaret e saj, nuk kane biznese dhe automjete në pronësi.

I është marrë deklaram si person që ka dijeni për rrethanat e veprës penale shtetasit Pjetër Gjezaj (babai i Gjon Gjezaj), i cili i pyetur në lidhje me pasuritë e paluajtshme në pronësinë e tij e të familjarëve dhe burimet e të ardhurave për blerjen e këtyre pasurive, ka deklaruar:

Aktualisht në pronësi të familjes kemi një Apartament garsonierë me sipërfaqe rreth 40 m<sup>2</sup>, në të cilën banojmë. Shtetasi Gjon (Shkëlzen) Pjetër GJEZAJ është i biri im, ndërsa Emiljan Zef GJEZAJ është djali i vëllait tim. Aktualisht të dy ndodhen të arrestuar në Spanjë që prej muajit Mars 2016.

-Në lidhje me tre apartamente të cilësuar në tre kontrata porosie, me kontratë noteriale Nr. 297 Rep./Nr. 99 Kol. datë 28.01.2015; me kontratë noteriale Nr. 3853 Rep./Nr. 929 Kol. datë 05.06.2012; me kontratë noteriale Nr. 4375 Rep./Nr. 1355 Kol. datë 22.07.2013, dua të deklaroj se kontratat janë lidhur nga djali im Gjon Gjezaj, por vetëm një apartament banimi është në pronësinë e djalit tim Gjon Gjezaj, konkretisht apartamenti i blerë me shumën 41 800 Euro, nga shoqëria "TRUST" sh.p.k, me NIPT L31404013K, me kontratë noteriale me Nr. 297 Rep./Nr. 99 Kol. datë 28.01.2015. Të ardhurat për blerjen e këtij apartamenti: Shoqërisë i është dhënë një automjet Benz C220 CDI me targa AA 757 FU, në pronësi të djalit, më pas pjesa e mbetur e detyrimit është bërë me këste. Të ardhurat e tjera për blerjen e këtij apartamenti janë të mbledhura nga puna ime dhe e djalit tim ne emigracion në Greqi vitet 1996 -2005 (me periudha), pasi unë së bashku me djalin tim Gjon Gjezaj, kemi punuar të dy së bashku në Greqi, nëpër kantiere, si saldator dhe kanë siguruar shuma të konsiderueshme të cilat janë përdorur për blerjen e këtij apartamenti si dhe për përballimin e shpenzimeve të familjes. Gjithashtu në kursimet e familjes janë edhe të ardhurat e vajzës Manola Arapaj nga paga, si dhe të bashkëshortes time e cila ka punuar si infermiere dhe prej vitit mars 2013 ka dalë në pension.

-Ndërsa dy apartamentet e tjera të banimit, të porositura te shoqëria "2AL" sh.p.k, me NIPT K31317006T, me kontratë noteriale Nr. 3853 Rep./Nr. 929 Kol. datë 05.06.2012 të ndodhura Kashar, dhe kontrata noteriale Nr. 4375 Rep./Nr. 1355 Kol. datë 22.07.2013, të porositura në vitin 2013, nuk kanë kaluar në pronësinë e djalit tim Gjon Gjezaj, pasi shoqëria ka falimentuar dhe nuk ka qenë korrekte në ndërtimin e tyre, si rrjedhojë nga ana jonë nuk kemi kryer asnjë pagesë, që nga momenti i lidhjes së kontratës së porosisë, pallati ka ngelur thjesht ne themel dhe nuk ka vazhduar ndërtimi. Ai ka deklaruar se ajo dhe familjaret e saj, nuk kane biznese dhe automjete në pronësi.

Me qëllim saktësimin e deklaramit të shtetasve Pjeter Gjezaj dhe Manjola Arapaj eshte kerkuar informacion ne Komunen Kashar ne lidhje me apartamentet e porositura nga shtetasit Gjon Gjezaj dhe Manjola Arapaj. Nga shkresa me numer 2821/1 prot, e dates 23.05.2017 jemi informuar se subjekti ndertues "2 A-L" sh.p.k. pasi nuk pagoi taksen e infrastruktures nuk eshte pajisur me leje zhvillimore ndertimi pavarsisht vendimit me numer 153, te dates 21.12.2012 te kryetarit per miratimin e lejes zhvillimore per ndertese banimi dhe sherbimesh 7-9 kat + 1 kat nentoke ne pronesi te familjeve Dragoti etj me vendodhje ne Yzberisht (Seksioni 1 dhe 2). Gjendja reale prej 4 vitesh ne terren eshte nje objekt i filluar si ndertim pa leje deri ne katin perdhe vetem nje seksion.

*Nisur nga sa me sipër,* nga hetimet e deritanishme rezulton se ne emer te shtetasit Gjeon Gjezaj ka nje pasuri e cila eshte ekzistente dhe eshte apartamenti i blere sipas kontratës me Nr. 297

Rep./Nr. 99 Kol. datë 28.01.2015, shtetasi Gjon Gjezaj ka lidhur një kontratë për kalim të drejtash reale për një apartament banimi me shoqërinë "TRUST" sh.p.k me NIPT L31404013K. Ky apartament ndodhet ne Kashar, apartament i ndertuar nga nga shoqerua "Sandy" mbi bazen e vendimit me numer 14, te dates 21.05.2010 te Komunes Kashar. Ky apartament eshte bleren ne vleren 41.800 euro shume e likujduar totalisht.

Nuk rezulton qe shtetasi Gjon Gjezaj apo familjare te tij te kene te ardhura te ligjshme te konfirmuara ne shumen e nevojshme per blerjen e ketij apartamenti.

Nderkohe ne baze te leterporosise te derguar nga autoretet spanjolle rezulton se shtetasi Gjon Gjezaj eshte pjese e nje grupi te strukturuar i cilia ka kryr vjedhje ne disa vende te Europes.

Per keto arsye ka dyshime te bazuara se kjo pasuri eshte blere si rezultat i te ardhurave te fitura ne menyre te kundraligjshme nga ky shtetas.

Ne lidhje me kete pasuri ekziston dyshimi i arsyeshem se disponimi i lire i saj nga shtetasi Gjon Gjezaj, apo te aferm te tij, mund te sjelle pasoja ne drejtim te tjetersimit, zhdukjes apo ketyre pasurive.

**Persa me siper bazuar ne nenet 274/2 te K.Pr.P. dhe 36 te K.P. nga Gjykata e Rrethit gjyqesor Kurbin**

#### **KERKOJME:**

Vendosjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi kete pasuri:

Apartamentin e banimit te blere ne baze te kontratës me Nr. 297 Rep./Nr. 99 Kol. datë 28.01.2015 qe shtetasi Gjon Gjezaj ka lidhur me shoqërinë "TRUST" sh.p.k me NIPT L31404013K. Ky apartament ndodhet ne Kashar, apartament i ndertuar nga nga shoqerua "Sandy" mbi bazen e vendimit me numer 14, te dates 21.05.2010 te Komunes Kashar

Kerkesen per mase sigurimi e bazojme ne keto akte:

- 1- Materiali I derguar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Lezhe me shkresen me numer 868 prot, te dates 11.10.2016.
- 2- Leterporosia e ekzekutuar nga autoritetet spanjolle te drejtesise ardhur me shkresen me numer 625/4 prot, te dates 07.07.2017 te Ministrise se Drejtesise.
- 3- Kqyrje ne Sistemin Tims te te dhenave.
- 4- Kqyrje ne Site te Aluiznit.
- 5- Infomacione kerkuar Zyres se Aluiznit Lezhe.
- 6- Akte te Zyres se Gjendjes Civile.
- 7- Te dhena te marra nga Zyrat e rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.
- 8- Te dhena te marra nga Bankat.
- 9- Te dhena te marra nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve.
- 10- Deklarimet e shtetases Manjola Arapi.
- 11- Procesverbal I marrjes dhe kqyrjes se dokumentave (akte te marra nga shtetasja Manjola Arapi).
- 12- Deklarimet e shtetasit Pjeter Gjezaj.

- 13- Procesverbal I marrjes dhe kqyrjes se dokumentave (akte te marra nga shtetasi Pjeter Gjezaj).

**PROKURORE E CESHTJES**

**Ajola PRENÇI**

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Ajola Prenci', written over a faint, circular, dotted stamp or watermark.